



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 50 datë 30.09.2025

**SHPREHJEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES  
KULLOSORE PREJ 202 HA, EKONOMIA KULLOSORE, "DOBRENJË -  
GJOGOVICË", NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHEPË, BASHKIA SKRAPAR.**

Këshillit Bashkisë Skrapar, në mbledhjen e datës 30.09.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Nd.e Shërbimit Pyjor, në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 111/2024 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar VKM -në nr. 398, datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", VKM-në nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore", i ndryshuar, VKM Nr. 467, datë 31.7.2025 Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme" Udhëzimi Nr.1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Kryetari i Bashkisë

VENDOSI

Shprehjen e pëlqimit në parim për dhënie me qira të sipërfaqes kullosore prej 202 ha në parcelat nr.12, nr.pasurisë 100 , sipërfaqe 60 ha, parcela nr.16, nr. pasurisë 110, sipërfaqe 80 ha, parcela nr.13, nr. pasurie 112, sipërfaqe 29.5 ha, parcela nr.13, nr. pasurisë 132, sipërfaqe 32.5 ha, Ekonomia kullosore, "Dobrenjë-Gjogovicë", Njësia Administrative Zhepë, Bashkia Skrapar.

Vendimi u miratua me 11 vota pro, vota kundër - 1 , abstenim – s'ka  
Për Konfirmim Prefektit të Qarkut Berat

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

